



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2019

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion.

Bulevardi _____, Tiranë

Email: _____

Në vijim të kërkesës suaj me nr.174/19 prot., drejtuar Bashkisë Shkodër me anë të postës elektronike dhe rregjistruar me nr.15814 prot, datë 19.09.2019, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” kërkoni informacion për, numrin dhe listën e objekteve akomoduese (hotel, hostel, etj), planin e ndarjes së territorit të plazhit të Velipojës në plazhe private, ju bëjmë me dije se:

Numri i pergjithshëm i njësive akomoduese në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër është 692. Nga këto, në qytetin Shkodër ushtrojnë veprimtarinë e tyre 69 subjekte, në zonën turistike të Velipojës 599 subjekte dhe atë të Thethit 24 subjekte. Këto të dhëna i përkasin vitit 2019.

Përsa i përket të dhënave për subjektet akomoduese për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018, jemi duke punuar për të nxjerrë një listë të saktë nga arshiva e programit tonë financiar sipas viteve të mësipërme. Në një kohë sa më të shkurtër, do ju dërgojmë dhe të dhënat për vitet e mësipërme.

Plani i ndarjes së territorit të plazhit të Velipojës, mund ta gjeni duke klikuar në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Hapesirat_Publike_Stacionet_e_Plazhit_256_1.php

Bashkangjitur, do të keni dhe listën e njësive akomoduese në qytetin Shkodër, Velipojë dhe Theth.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

KRYETAR

Voltana Ademi